



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:287740

Datë: 13.01.2021

Numri i dokumentit: 01404429

P.nr.1102/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. Sh nga Gjilani, për shkak të veprës kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Sevdail Robelli nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1196/2019, të datës 09.12.2019, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datat 13.10.2020, 04.11.2020, 01.12.2020, 24.12.2020 dhe 28.12.2020 mori dhe shpalli ndërsa me datë 13.01.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. Sh, nga babai R. dhe nëna R., e lindur K., i lindur me datë ... në Gjilan, ku edhe jeton në i pa martuar, me profesion zyrtar policor pranë Stacionit Policor në Gjilan ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-ës

LIROHET NGA AKUZA

Sepse me datë 01.11.2019, rreth orës 22:00 h, në Gjilan, në kafiterinë ... për shkak të një deklaratë që e kishte dhënë para organeve kompetente, me fjalë, vepra ose gjeste se do të shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit, ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin F. Sh, nga Gjilani, në atë mënyrë që e kishte ndal tek dera e këtij lokali, të njejtin dhe në fillim iu kishte drejtuar me fjalët “a je ti F. Sh” dhe kur ky i ishte përgjigjur “po unë jam”, atëherë ky i kishte thënë të njëjtit “unë jam F. Sh., ti ke qenë dëshmitarë kundër meje në rastin e vëllezërve D., a e dinë se e ke shti therrën në këmbë të shëndoshë, kam me ua q.. robët në p..., ty dhe vëllezërve D., kam me ju ngreh zhag”, dhe më pas edhe e prek me dorë në krah dhe i thotë “hajt se ke me pa”, me ç’rast tek i dëmtuari ka shkaktuar ankth dhe frikë sepse një rast gjyqësor ky kishte dëshmuar kundër tij dhe me arsye tani frikësohej se i njejtin do ti hakmerret prandaj rastin e kishte raportuar në polici.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës.

I dëmtuari F. Sh për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 10.12.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1996/19, kundër të akuzuarit F. Sh nga Gjilani, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Gjykata me datë 16.06.2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën ishin të ftuar dhe prezent prokurorja e shtetit, i dëmtuari F. K. dhe i akuzuari F. Sh.. Në këtë seancë i akuzuari F. Sh, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se edhe pse e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, nuk e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç'rast gjykata në kuptim të nenit 245 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1,6.2 dh 6.3 të KPP-ës e ka njoftuar të akuzuarin se mund të paraqes kundërshtimet për provat e cekura në aktakuzë si dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës mirëpo përkundër këtij njoftimi i akuzuari nuk e ka shfrytëzuar një të drejtë të tillë me ç'rast me krijimin e kushteve ligjore me urdhër është caktuar seanca e shqyrtimit gjyqësor për datë 13.10.2020, e të cilat seanca kanë vazhduar edhe me datat 04.11.2020, 01.12.2020, 24.12.2020 ku janë administruar provat e paraqitura nga palët procedurale si dhe të njëjtit kanë dhënë edhe fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga rrjedha e këtij shqyrtimi gjyqësor, shtjellimit të provave materiale dhe atyre personale konsideron se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari F. Sh, në ditën, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës lëndore e kishte kërcënuar tani të dëmtuarin, ky fakt është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit i cili ishte i qartë, bindës dhe argumentues se atë mbrëmje kishte dalë për qejf në kafiteri dhe pas tij, pas pranimit të një telefonate kishte dal F. Sh ,ku i njëjti i kishte kërkuar sqarim për një çështje të më hershme ku i dëmtuari kishte qenë dëshmitar e më pas edhe e kishte kërcënuar me fjalë dhe nga ky kërcënim i njëjti kishte ndër ankth, frikë dhe pa siguri për jetë sa që një kohë nuk kishte pasur guximin të kalonte rrugës së zakonshme në qytet mirëpo kishte kaluar nëpër rrugë të tjera, se me të vërtetë kjo kanosje kishte ndodhur është vërtetuar edhe nga deklaratat e F. Sh ngase pasi e kishte njohur se kush ishte i kishte kërkuar sqarim dhe si zyrtarë policor që është konsideroj se e din që çështjet e tilla nuk sqarohen në rrugë dhe nuk është e domosdoshme ti bëhet me dije dikujt se do të ndjek procedura ligjore kundër teje, se me të vërtetë e kishte kërcënuar është vërtetuar edhe nga fakti se i njëjti edhe pse e kishte ditur se kush është i dëmtuari i kishte kërkuar medoemos identitetin e tij përkundër se i dëmtuari ishte përgjigjur me një identitet tjetër, çfarë shpjegime ka kjo nëse jo kërcënuese, për më tepër edhe i akuzuari vetë e pohoi se edhe i dëmtuari i kishte thënë se nuk dëshironte probleme, ky fakt u vërtetua edhe nga dëshmitari Q. B , i cili i kishte intervistuar të dy palët ku as vet i akuzuari nuk e kishte mohuar se kishte pasur një bisedë të

tillë përveç natyrisht atyre që i shkojnë në dëm të tij dhe e gjitha kjo me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, dhe me të vërtetë në ditën, vendin, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv ish-in takuar u vërtetua edhe nga CD-ja e incizimit të vendit të ngjarjes, bile edhe përshkruan vendin se ku kanë qenë andaj duke u bazuar në provat e administruara prokuroria ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njëjta i përmban dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti jep një dënim meritor sipas ligjit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në mënyrë që me dënimin e shqiptuar të arrihet edhe qëllimi i tij, që qytetarët të parandalojë që të kryejnë veprë penale dhe njëkohësisht të jetë një satisfaksion për të dëmtuarin.

I dëmtuari F. Sh ,në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe se nuk ka se çfarë të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. Sh avokati Sevdail Robelli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se siç është deklaruar në fjalën hyrëse në fillim të këtij procesi gjyqësor ashtu edhe u vërtetua se gjatë këtij procesi gjyqësor prokuroria nuk arriti të sjellë prova që të dëshmojë fajësinë e të mbrojturit të tij e që pikërisht është detyrim ligjor i prokurorisë që me prova e fakte ta dëshmojë këtë para gjykatës, provat të tilla si p.sh. akti përcjellës i stacionit policor ne Gjilan drejtuar IPK të Kosovës, apo thirrja e IPK drejtuar të akuzuarit F. Sh dhe disa të tjera në asnjë mënyrë dhe për asnjë arsye gjykata nuk duhet ti marrë e as ti vlerësoj si prova sepse janë thjeshtë akte të organeve të tjera shtetërore të cilat dëshmojnë se janë kryer veprime procedural krejt të parëndësishme për këtë çështje. Prokuroria Themelore ka dështuar që me çfarëdo prove para kësaj gjykate të dëshmojë frikën dhe ankthin e të dëmtuarit e që përbënë element shume të rëndësishëm për figurën e kësaj veprë penale, është dashur që prokuroria këtu të sjellë një raport mjekësor të natyrë psikiatrike dhe të bindë se me të vërtete F. Sh ka qenë i frikësuar nga veprimet e F. Sh, Në fjalën përfundimtare prokurorja deklaroj se F. Sh nga frika ka shfrytëzuar rrugë të tjera për të shkuar në punë, ndërsa që vetë F. Sh ,para kësaj gjykate në dëshminë e tij ka treguar se e shfrytëzon pikërisht këtë rrugë, rrugën para gjykatës për të shkuar në punë dhe kjo tregon se ai nuk ka qenë dhe nuk ka mundur të jetë i frikësuar, si dëshmitarë i prokurorisë para gjykatës është paraqitur inspektori Q.B i cili në seancën e datës 01.12.2020 nuk ka treguar asgjë në mënyrë absolute se si F. Sh e ka kryer veprën penale, përkundër detyrimit të tij ligjor si hetues që të mbledhë prova dhe ato t'ia dorëzoj prokurorisë dhe se ky dëshmitar ka qenë parashtrues i kallëzimit penal i cili me një urdhër nga hierarkia e tij ka qenë i detyruar ti kryej veprimet e caktuar ligjore dhe edhe për kundër faktit që nuk ka sjell asnjë provë ne konsiderojmë se përpiluesi i kallëzimit penal nuk mund të jetë dëshmitarë në një proces gjyqësor sepse ai thjesht i ka zbatuar detyrat e tij. E tërë aktakuza e ngritur është bazuar vetëm në deklaratën e të dëmtuarit F. Sh ,dhe nuk është e mbështetur ne asnjë provë tjetër, kjo është në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 2 të KPP-së dhe mbrojtja kërkon nga gjykata që në zbatim të kësaj dispozite ligjore në bazë të parimit in dubio pro reo, i akuzuari F. Sh ,të shpallet i pa fajshëm. Në rastin konkret kemi një deklaratë nga i dëmtuari dhe një deklaratë nga i mbrojturi i tij i cili e mohon dhe e vërteton se nuk e ka kryer veprën penale. CD e propozuar nga prokuroria si provë siç është parë në seancë nuk tregon asgjë lidhur me zbardhjen e këtij rasti, ndërsa sa i përket çështjes lidhur me të kaluarën kriminale ia përkujtojmë gjykatës se asnjëra nga ato dy raste që u përmendën nuk kanë aktgjykim përfundimtar dhe rrjedhimisht nuk

kanë ndonjë peshë në marrjen e vendimit final. Është e vërtetë që F. Sh e ka takuar F. Sh siç e përshkruajti edhe vetë në mbrojtjen e tij mirëpo me asnjë veprim, fjalë apo gjest nuk e ka kanosur të dëmtuarin andaj mbrojtja ka kërkuar nga gjykata që në kuptim të nenit 364 të KPP paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPP-së të nxirret aktgjykim lirues në atë mënyrë që F. Sh të lirohet nga akuza sepse gjatë këtij procesi gjyqësor nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë nga prokuroria.

I akuzuari F. Sh në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka se çfarë të shtojë tjetër.

## 2. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë në bazë të:

- Dëgjimit të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit F. Sh,
- Dëgjimit të dëshmitarit Q. B,
- Leximit dhe shikimit të provave materiale si: formulari i ankesës së qytetarëve ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës të datës 02.11.2019, akti përcjellës i Stacionit Policor në Gjilan, me të cilën kjo ankesë është dorëzuar në IPK me numër ... e datës 04.11.2019, deklarata e të dëmtuarit të dhënë në stacionin policor në Gjilan me datë 02.11.2019, raporti informues i Q. B me numër të referencës ... i datës 04.11.2019, kërkesa e hetuesit Q. B që iu është drejtuar P.TH në Gjilan, për të dhënë urdhër për të siguruar video incizimet nga kamerat e lokalit ,urdhëresa e prokurorisë me numër PPN.II.nr.689/19 të datës 14.11.2019, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në IPK me datë 26.11.2019, kërkesa e hetuesit të përmendur drejtuar D. S me datë 26.11.2019 për të kaluarën kriminale për të paraqiturin dhe përgjigjja e saj bashkë me rastet për të cilat në të kaluarën është përgjigjur i paraqituri, 1 DVD me incizim nga vendi i ngjarjes dhe
- Mbrojtjen e të akuzuarit F. Sh.

### 2.1. Deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit F. Sh e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

I dëmtuari F. Sh në cilësinë e dëshmitarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se unë në polici kam raportuar një rast të kanosjes nga F. Sh, ku me datë 01.11.2019 kishte dalë në kafiterinë , rreth orës 21:30 minuta me një baxhanak të tij nga Prizreni, e ku pas 30 minutave e kishte pasur një telefonat nga familja dhe kishte dalë jashtë kafiterisë për shkak të zhurmës se nuk ishte dëgjuar brenda, pasi që e kishte përfunduar telefonatën dhe kur kishte dashur të kthehej brenda F. Sh ia kishte zënë derën dhe i dëmtuari i ishte drejtuar me fjalët a ke mundësi të ma lirosh rrugën, i njëjti i kishte thënë jo dhe i ishte drejtuar “a po më njeh se kush jam” dhe meqenëse ai kishte një mjekër më të madhe një herë nuk e njoha, por pasi i kishte treguar se kush është i dëmtuari i ishte përgjigjur “ po tash po të njoh”, i akuzuari i ishte drejtuar me fjalët “a je ti F. Sh, ky i ishte përgjigjur që po ai ishte ndërsa i akuzuari i kishte thënë “ a e din që je kon dëshmitarë kundër meje dhe e ke shti therën

në kom të shnosh dhe kom me ju ngreh zhag ty dhe vëllezërit D. ka me iu qi robt në p...” ndërsa i dëmtuari i ishte përgjigjur duke i thënë “më fal që ka mundësi mos me bo probleme se e kam një baxhanak prej Prizreni dhe kam një festë dhe dua me i ikë probleme”, më pas i akuzuari ia kishte lëshuar rrugën dhe ky kishte hyrë brenda , e kishte bërë pagesën dhe i kishte thënë baxhanakut të tij të largohen nga aty se nuk ishte puna mirë ngase po e thërrasin në shtëpi ngase të njëjtit nuk ia kishte treguar arsyen e vërtet pse duhet të largoheshin nga aty. Pasi ishte larguar nga aty së pari kishte shkuar në shtëpinë e tij më pas kishte shkuar në polici për ta lajmëruar rastin mirëpo aty i kishin thënë që të vijë të nesërmen ta lajmërojë rasti kur edhe të nesërmen e kishte paraqitur rastin në polici gjithashtu i njëjti kishte deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit si dhe parashton kërkesë pasurore juridike.

## 2.2 Deklarata e dëshmitarit Q.B e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Dëshmitari Q. B në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtet se ai e kishte intervistuar edhe të dëmtuarin edhe të akuzuarin, kur ishte intervistuar i dëmtuari ai ishte ndjerë i frikësuar nga F. Sh dhe se gjatë intervistës e kishte cekur se nuk është duke dal shumë me qëllim që ti shmangët takimit me F. Sh. I akuzuari edhe në IPK e kishte cekur se kishte dalë jashtë dhe e kishte pritur të dëmtuarin dhe se me të njëjtin edhe ishte takuar. I dëmtuari gjatë intervistimit kishte thënë se është kërcënuar nga F. Sh i cili i kishte thënë “pse ke rrejt në rastin e vëllezërve D. dhe ty dhe vëllezërve D. ka me iu ngreh zhag” ndërsa F. Sh gjatë intervistës e kishte pranuar se kur e kishte parë F. Sh kishte dalë jashtë dhe pasi që i dëmtuari e kishte përfunduar bisedën në telefon ky e kishte ndaluar dhe i kishte thënë “a je të F. Sh që ke dëshmu kundër meje” dhe sipas F. Sh i dëmtuari i ishte përgjigjur se “nuk jam F.po F.” ndërsa i akuzuari, i kishte thënë përsëri “ti je F. Sh dhe se unë nuk do ta lë me kaq dhe do ti ndjeki procedurat ligjore”, mirëpo i njëjti në asnjë rrethanë nuk e kishte pranuar se i kishte thënë të dëmtuarit do t’iu ngreh zhag apo i ka kërcënuar, i njëjti ka shtuar se me sa e di F. Sh është duke punuar si hetues policor ndërsa kohën kur ka ndodhur rasti ka qenë i suspenduar për një rast tjetër.

## 2.3 Mbrojtja e të akuzuarit F. Sh

I akuzuari F. Sh, në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në Policinë e Kosovës punon që nga viti 2012, për F. Sh , kishte dëgjuar për herë të parë me një rast tjetër penal ku i njëjti ishte propozuar si dëshmitarë nga ana e avokatëve, tek pastaj e kishte parë edhe në seancë dhe e kishte njohur edhe fizikisht, ky dëshmitarë në atë proces ishte paraqitur pas 5 viteve, lidhur me atë proces i akuzuari kishte pritur që të përfundoj çështja me aktgjykim të formës së prerë dhe se rasti tani është në Gjykatën e Apelit dhe në rastin e më hershëm ku ka deklaruar si dëshmitar ka prezantuar foto të rreme në gjykatë, dhe i njëjti kishte propozuar fotot e tija në atë proces, andaj edhe kishte kërkuar nga prokurori që të iniciohet një procedurë penale ndaj të akuzuarit F. Sh për deklarim të rremë. Të dëmtuarin e kishte takuar ne lokalin me datë 01.11.2019, ku i kishin bërë përshtypje disa shikime të tija që ia kishte bërë herë pas here ndërsa në dalje të lokalit i akuzuari kishte qenë duke biseduar në telefon dhe e kishte parë që edhe i dëmtuari ishte jashtë duke biseduar në telefon, e kishte pritur derisa ai e kishte përfunduar bisedën telefonike dhe më pas të njëjtin e kishte ndal dhe i kishte kërkuar që të bisedojnë dhe ti tregojë arsyen se pse po e shikonte në atë mënyre, i kishte thënë “ a je ti F. Sh”

ndërsa i dëmtuari i ishte përgjigjur “ jo unë jam F. Sh” dhe më pas i kishte thënë të dëmtuarit se po i kujtohet që ai ishte dëshmitar në një rast tjetër penal të zhvilluar ndaj tani të akuzuari dhe se pse po e shikonte ashtu, i dëmtuari i ishte përgjigjur se ai nuk ishte F. Sh por ishte F., ndërsa i akuzuari kishte vazhduar ti thotë se i intereson se cila ishte arsyeja dhe se çfarë kishte përfituar nga deklarimi i rrem dhe sa para i kishte marrë, atëherë i njëjti i ishte përgjigjur “pare nuk kam marrë”, pastaj i akuzuari sërish kishte vazhduar duke e pyetur dhe i thënë se ti je F. Sh kur i dëmtuari i ishte përgjigjur se “po unë jam dhe nëse donë po ta jap numrin e telefonit dhe që donë dalim me bisedu se jam me një baxhanak”, më pas i akuzuari i kishte thënë sërish “në rregull por dije se unë do ti ndjek procedurat ligjore për atë që ke deklaruar ti”. I njëjti po ashtu ka deklaruar se nuk është e vërtetë ajo se çfarë ka deklaruar i dëmtuari lidhur me mënyrën e kërcënimit dhe se nëse i njëjti ndihet i kërcënuar ngase ai i kishte thënë se do ti ndjekë rrugët ligjore dhe se për këto çështje le të ndihet edhe sot i kërcënuar ndërsa për fizikisht mos të ndihet kurrë i kërcënuar.

### 3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata komfor nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç’rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Fatlum Shabani ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Gjykata deri tek një konstatim i tillë erdhi duke nxjerr përfundimet mbi faktet kontestuese dhe jo kontestuese në këtë çështje penalo juridike ashtu që gjykata gjeti se nuk ishte kontestuese se i akuzuari dhe i dëmtuari njiheshin edhe më parë nga një proces tjetër gjyqësor i cili ishte zhvilluar ndaj të akuzuarit, nuk ishte kontestues fakti se me datë 01.11.2019 në kafiterinë në Gjilan, rreth orës 22:00 h të njëjti ishin takuar jashtë derës së kësaj kafiterie siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nuk ishte kontestues as fakti se i akuzuari dhe i dëmtuari kishin zhvilluar bisedë mes tyre sepse këto fakte gjejnë mbështetje edhe në vet deklaratimet e të dëmtuarit dhe të akuzuarit të bëra pranë Stacionit Policor në Gjilan, IPK-ës dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor por bazuar në të lartcekurat gjykata gjeti se fakti i vetëm kontestues ishte nëse i akuzuari F. Sh e kishte kanosur të dëmtuarin F. Sh me fjalët “*unë jam F.Sh, ti ke qenë dëshmitarë kundër meje në rastin e vëllezërve D., a e dinë se e ke shti therrën në këmbë të shëndoshë, kam me ua q.. robët në p..., ty dhe vëllezërve D., kam me ju ngreh zhag*”, dhe më pas edhe e prek me dorë në krah dhe i thotë “*hajt se ke me pa*”, mirëpo këtë fakt kontestues gjykata e zgjodhi duke u bazuar në atë se ky pretendim nuk gjen mbështetje dhe nuk provohet me asnjë nga provat materiale apo personale të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, kur e themi këtë gjithnjë kemi parasysh se nga provat materiale si formulari i ankesës së qytetarëve ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës të datës 02.11.2019, akti përcjellës i

Stacionit Policor në Gjilan, me të cilën ankesa e të dëmtuarit ishte dorëzuar në IPK me numër ... datës 04.11.2019, raporti informues i Q. B me numër të referencës ... i datës 04.11.2019, kërkesa e hetuesit Q. B që iu është drejtuar P.TH në Gjilan, për të dhënë urdhër për të siguruar video incizimet nga kamerat e lokalit ... urdhëresa e prokurorisë me numër PPN.II.nr.689/19 të datës 14.11.2019, kërkesa e hetuesit të përmendur drejtuar D. S. me datë 26.11.2019 për të kaluarën kriminale për të paraqiturin dhe përgjigjja e saj bashkë me rastet për të cilat në të kaluarën është përgjigjur i paraqituri, gjykata nuk është bindur se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar ngase për gjykatën provat e lartcekura janë jo relevante dhe nuk kanë asnjë peshë në drejtim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike meqenëse të njëjtat vetëm se dëshmojnë veprimet hetimore të cilat janë ndërmarrë nga organet kompetente pas paraqitjes së rastit në polici nga ana e të dëmtuari por me to nuk vërtetohet objekti i akuzës i cili ishte kanosja ndaj të dëmtuarit.

Pretendimi se i akuzuari e ka kanosur të dëmtuarin siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi nuk gjen mbështetje as në CD-në me video incizim e cila është administruar nga ana e gjykatës dhe pas shikimit të saj në seancën e shqyrtimit gjyqësor i dëmtuari pas pyetjes nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues kishte deklaruar se *“në këto video incizime unë nuk kam mundur ta identifikojë vetveten e as F. Sh”*, njëjtë siç kishte deklaruar edhe vet i akuzuari *“unë në këto video incizime nuk kam mundur që ta identifikojë vetveten, po ashtu as të dëmtuarin nuk kam mundur ta identifikojë”*.

Andaj duke pasur parasysh të lartcekurat dhe atë se pretendimi i prokurorit të shtetit gjen mbështetje vetëm në deklaratat e të dëmtuarit të dhëna në polici, IPK dhe shqyrtim gjyqësor dhe se asnjë nga provat e tjera çoftë ato materiale apo personale nuk e mbështesin një pretendim të tillë duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPP-ës sipas të cilit *“mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, gjykata edhe mëdyshjet lidhur me këtë çështje penalo juridike i interpretoi në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij dhe si rrjedhojë erdhi në përfundim se në këtë çështje penalo juridike nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari F. Sh ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës andaj edhe të njëjtin e liroi nga akuza.

Nga deklarata e dëshmitarit Q.B të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk arriti të vërtetojë asnjë fakt të rëndësishëm në drejtim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi përveç asaj që i njëjti kishte deklaruar se pas pranimit të ankesës nga i dëmtuari, kishin marrë veprimet e nevojshme hetimore si IPK dhe më pas edhe kishin parashtruar kallëzimin penal pranë Prokurorisë Themelore në Gjilan.

## 5. Vendimi për lirim të akuzuarit nga akuza

Meqenëse nuk është vërtetuar se i akuzuari F. Sh nga Gjilani, ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së, gjykata të njëjtin e liroi nga akuza në bazë të nenit 364 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së.

#### 6. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh deklarinimin e të dëmtuarit F. K se i njëjti lidhur me këtë çështje penale juridike parashtron kërkesë pasurore juridike, gjykata për një gjë të tillë e udhëzon në kontest civil.

#### 7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nënin 454 paragrafi 1 të KPP-ës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1102/2019, me datë 13.01.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.



Numri i lëndës: 2019:287740  
Datë: 13.01.2021  
Numri i dokumentit: 01404429